

# **Drejtoria Arsmore e Filadelfias**

**Klasa e Dytë, Udhëzues për Prindërit**  
*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*  
*Parent Study Guide for 2nd Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Përshkruajnë personazhet, evidentojnë ngjarjet kryesore, vendndodhjen ose problemet në një tregim ose tekst që ata kanë lexuar ose dëgjuar.
- Lexojnë në mënyrë të pavarur tregime të gjata dhe libra, ku përfshihen edhe ata me kapituj.
- Flasin rreth ideve kryesore në tregimet dhe librat që ata lexojnë.
- Bëjnë lidhje midis informacionit të ri të marrë nga një tregim apo libër dhe asaj që fëmija ka njohuri ndërkohë rreth një teme apo libri tjetër, filmi, ose programi televiziv.
- Shkruajnë rreth një teme specifike, si rreth një kafshe shtëpiake që i pëlqen më shumë, në një paragraf të plotë.
- Bëjnë përshkrime, raporte, letra dhe instruksione për mënyrën se si të bëjë diçka.



# Matematikë

## Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të

- Identifikojnë numrat e plotë dhe thyesat.
- Paraqesin të njëjtin numër me mënyra të ndryshme, p.sh.,  $18+12, 20+10, XXX$
- Njohin lidhjen midis mbledhjes dhe zbritjes së numrave.
- Mbledhin dhe zbresin numrat tek dhe dyshifrorë.
- Zgjidhin probleme me paratë duke përdorur dollarët dhe centët.
- Identifikojë kur duhen përdorur njësitë matëse inches, feet dhe yards.
- Të njohin kohën në orët me shifra dhe ato tradicionale (me akrep) dhe të përcaktojnë sa kohë ka kaluar .
- Bëjnë parashikime, mbledhin, ndajnë sipas llojeve, organizojnë, paraqesin dhe interpretojnë të dhënat në skica, grafikë dhe tabela.
- Njohin dhe shtrijnë përdorimin e modeleve me forma dhe numra.
- Zgjidhin fjali me numra dhe përcaktojnë pjesët që mungojnë.
- Përdorin shenjat +,-, dhe = për të krijuar një pjesë tregimore me numra.
- Emërtojnë, vizatojnë, përshkruajnë format gjeometrike dy dhe tre dimensionale si trekëndëshat, katrorët dhe drejtë-këndëshat.
- Spjegojnë me fjalët e tyre zgjidhjen e një problem matematik.
- Lidh mbledhjen e përsëritur.

# Shkencë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Përdorin instrumentet matëse, si vizorja për të mledhur informacion për objekte të ndryshme.
- Kuptojnë konceptin e ndryshimit të motit çdo ditë, por gjërat si temperature mesatare ose rreshjet ndjekin një mesatare mujore.
- Identifikojnë instrumentet e përdorur nga metereologët për vrojtimin e konditave atmosferike.
- Spjegojnë që ndryshimet në botën e gjallë çfaqen gjatë gjithë kohës dhe kanë ciklet tyre e jetësore ku përfshihet lindja, rritja, riprodhimi dhe vdekja eventuale.



# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Kuptojnë dhe shpjegojnë gjeografinë e komunitetit të tyre.
- Analizojnë si individët, familjet dhe grupet kanë ngjashmëri dhe dallime.
- Studjojnë në mënyrë investigative dhe paraqesin një ekspozë rreth historisë Afrikanë-Amerikane.
- Tregojnë se kuptojnë si komunitetet ndryshojnë me kalimin e kohës.
- Diskutojnë vartësinë e njerëzve nga ambienti fizik dhe përdorin burimet natyrore për nevojat e tyre jetësore.



# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

- Kuptojnë ndjenjat dhe rrugët më të mira për ti shprehur ato.
- Identifikojnë ndihmuesit e komunitetit në lagje.
- Identifikojnë rrugët për shmangien e një konflikti.
- Marrin pjesë në aktivitete ku përfshihen kërcimet, kthimet, hedhjet, zvarritjet, uljet dhe ngritjet.
- Demonstrojnë zbatim të rregullave për sigurimin e jetës kur ecin, kapërcejnë rrugën dhe ngasin biçikletën.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të aftë të**

### Art

- Tregojnë kontroll dhe konfidencë në përdorimin e lapsave, bojrave dhe argjilës për të bërë art.
- Dijnë që artistët bëjnë lloje të ndryshme arti nga një shumëllojshmëri ideshë.
- Përcaktojnë forma të ndryshme të artit si portreti, peisazhi dhe skulptura.

### Muzikë

- Luajnë ritme të thjeshta për të shoqëruar këngë, vargje dhe poezi të ndryshme.
- Këndojnë dhe interpretojnë këngë për të mësuar karakteristika të tilla si i lartë/i butë, shpejt/ngadalë.